



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

---

KPPP.nr.99/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtarja Verona Dibra, në çështjen juridike përmbartimore të kreditorit “Albaeletterica Kosova” SH.P.K., me NRB:70676923, me seli në Obiliq, Prishtinë-Mitrovicë km 3-të, Shkabaj, kundër debitorit “Shkëmbi - Gllarevë” SH.P.K., me NRB: 70513544, me seli në Klinë, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson J.O., avokat nga Prishtina, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr.639/22 të datës 21.12.2022, të Përmbartuesit Privat Destan Bujupaj, jashtë seancës, me datë 09.07.2023, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. APROVOHET pjesërisht prapësimi i debitorit debitorit “Shkëmbi - Gllarevë” SH.P.K., dhe ANULOHET pjesërisht Urdhri Përmbartimor P.nr.639/22 i datës 21.12.2022, i Përmbartuesit Privat Destan Bujupaj për pjesën e detyrimit në shumën prej 7,380.32 € (shtatë mijë e treqind e tetëdhjetë euro e tridhjetë e dy cent).
- II. REFUZOHET pjesërisht prapësimi i debitorit “Shkëmbi - Gllarevë” SH.P.K., dhe MBETET NË FUQI pjesa tjetër e Urdhrit Përmbartimor P.nr.639/22 të datës 21.12.2022, të përmbartuesit privat Destan Bujupaj, sa i përket shumës prej 13,137.02 € (trembëdhjetë mijë e njëqind e tridhjetë e shtatë euro e dy cent) së bashku me kamatën ligjore sipas normës së interesit vjetor prej 8%.
- III. PËRFUNDOHET pjesërisht procedura përmbartimore e kreditorit “Albaeletterica Kosova” SH.P.K., ndaj debitorit “Shkëmbi - Gllarevë” SH.P.K., sipas urdhrit përmbartimor P.nr.639/22 të datës 21.12.2022, për shumën prej 7,380.32 € (shtatë mijë e treqind e tetëdhjetë euro e tridhjetë e dy cent).

A r s y e t i m

Përmbartuesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit, ka lëshuar urdhrin përmbartimor P.nr.639/22 e datës 21.12.2022, me të cilin ka lejuar përmbartimin në bazë të

dokumentit të besueshëm - Faturës nr.FS09409 të datës 22.04.2020, Faturës nr.FS09317 të datës 31.03.2020, Faturës nr.FS09329 të datës 04.04.2020, Faturës nr.FS09330 të datës 04.04.2020, Faturës nr.FS09333 të datës 04.04.2020, Faturës nr.FS09347 të datës 07.04.2020, Faturës nr.FS09371 të datës 10.04.2020, Faturës nr.FS09387 të datës 14.04.2020, Faturës nr.FS09433 të datës 27.04.2020, Faturës nr.FS096196 të datës 16.05.2020, Faturës nr.FS09465 të datës 02.05.2020, duke urdhëruar debitorin që në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij urdhri, t'ia paguaj borxhin në shumën prej 20,517.34 €, me kamatë ligjore prej 8%, si dhe të paguaj të gjitha shpenzimet e procedurës që do të krijohen prej momentit të dorëzimit të këtij propozimi e deri në përfundim të procedurës, nën kërcënimin të përmbarimit të dhunshëm, në të kundërtën realizimi i përmbarimit të bëhet përmes ndalimit të mjeteve në para të cilat debitori i ka në llogaritë bankare, sekuestrimin e letrave me vlerë, regjistrimin, sekuestrimin, vlerësimin, dhe shitjen e sendeve të luajtshme dhe të paluajtshme të debitorit deri në përmbushjen e borxhit të kërkuar nga kreditori.

Debitori në prapësimin e paraqitur brenda afatit ligjor, ka kundërshtuar në tërësi urdhrin e lejuar për përmbarim me arsyetimin se dokumenti në bazë të cilit është marrë urdhri për përmbarim nuk ka tipare të përmbarueshmërisë, e ka humbur efektin juridik dhe nuk përmbush kushtin nga neni 40 par 2 i LPP-së, pasi që nuk tregohet fare se në bazë të cilit dokument të besueshëm caktohet përmbarimi, nuk përmban kredinë e cila duhet të paguhet nga ana e debitorit, mjeti dhe objekti i përmbarimit, afatin e zgjidhjes së kredisë e as të dhënat e tjera të nevojshme për zbatimin e përmbarimit. Më tutje ka theksuar se kreditori me asnjë provë të vetme nuk e ka dokumentuar se ka arritur afati për përmbarimin e obligimit sipas faturave të cekura në propozim, të cilat fatura nuk e kanë vulën e blerësit por vetëm vulën e shitësit e në shumicën e faturave nuk ka as nënshkrim të palëve. Ka shtuar se nuk ka marrë asnjë paralajmërim nga ana e kreditorit për dërgimin e faturave në përmbarim. Gjykatës i ka propozuar që të aprovohet në tërësi prapësimi si i bazuar dhe të anulohet urdhri përmbarimor P.nr.639/22 i datës 21.12.2022, i Përmbaruesit Privat Destan Bujupaj.

Kreditori në përgjigjen në prapësim ka kundërshtuar pretendimet e debitorit të cekura në prapësim, duke theksuar se vërehet qartazi se qëllimi i debitorit është vetëm shtyrja dhe prolongimi i pagesës së borxhit. Tutje ka theksuar se faturat në bazë të cilave është i lejuar urdhri për përmbarim janë origjinale të pranuar dhe të nënshkruara nga ana e debitorit si pranues i mallit, të cilat e kanë afatin për pagesë e borxhit dhe plotësojnë të gjitha kushtet konform dispozitave të LPP-së. Më tutje ka shtuar se sa i përket pretendimeve të debitorit se

nuk ka qenë i njoftuar për dërgimin e faturave në përmbardim, nuk qëndrojnë për faktin se debitori është i njoftuar përmes emailit zyrtar dhe komunikimeve tjera elektronike se në rast të mos pagesës së borxhit faturat do të dërgohen të përmbarduesi privat. I ka propozuar gjykatës të refuzohet në tërësi si i pa bazuar prapësimi i debitorit, ndërsa urdhri për përmbardim P.nr.639/22 i datës 21.12.2022, të mbetet në fuqi.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, kundërshtimeve të kreditorit nga përgjigjja në prapësim dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbardimore, (tutje LPP) dhe nenit 12 par. 2 të Ligjit Nr. 05/L-118 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbardimore, gjeti se prapësimi i debitorit është pjesërisht i pabazuar dhe vendosi si në dispozitiv të këtij Aktvendimi, për shkaqet si në vijim:

Gjykata pas shqyrtimit të shkresave të lëndës gjeti se Urdhri Përmbardimor P.nr.639/22 i datës 21.12.2022, duhet të anulohet pjesërisht për borxhin e kërkuar nga kreditori sipas Faturës nr.FS09409 të datës 22.04.2020 dhe Faturës nr.FS09333 të datës 04.04.2020, për shkak se këto fatura nuk i plotësojnë kushtet e parapara me nenin 29 dhe nenin 37 të LPP-së.

Gjykata gjeti se Fatura nr.FS09409 e datës 22.04.2020 dhe Fatura nr.FS09333 e datës 04.04.2020, nuk i plotësojnë kushtet ligjore për të qenë dokumente të besueshëm, për faktin se të njëjtat janë lëshuar në mënyrë të njëanshme nga ana e kreditorit dhe nuk janë pranuar nga debitori, përkatësisht nuk përmbajnë nënshkrimin e as vulën e pranuesit-debitorit dhe nuk ka dëshmi se të njëjtat janë pranuar nga debitori.

Andaj, duke qenë se debitori nuk i ka pranuar në mënyrë të rregullt faturat, si të tilla të njëjtat nuk mund të shërbejnë si dokumente të besueshme dhe nuk kanë tipare të përmbardueshmërisë, përderisa njëra palë procedurale - debitori nuk ka pranuar një detyrim që rrjedh nga faturat.

Gjykata po ashtu gjeti se borxhi i kërkuar nga kreditori sipas Faturës nr.FS09387 të datës 14.04.2020, në shumën prej 6,675.50 €, është përmbushur nga ana e debitorit. Gjykata erdhi në këtë përfundim pasi që në nr.FS09387 të datës 14.04.2020, të bashkëngjitur propozimit për përmbardim figuron vula se e njëjta është “e paguar”, andaj gjykata në kuptim

të nenit 71 par.1 nën par.1.2, ku përcaktohet se: “dokumenti në bazë të cilit është marr vendimi përmbarues ose urdhri përmbarues është prishur anuluar, ndryshuar ose shfuqizuar në një mënyrë tjetër, gjegjësisht nëse në ndonjë mënyrë e ka humbur efektin e tij ose është konkluduar se është pa efekt juridik”, aprovoi prapësimin e debitorit edhe sa i përket kësaj fature, pasi që dokumenti i besueshëm – Fatura FS09387 e datës 14.04.2020, në bazë të së cilës është lejuar urdhri përmbarimor, e ka humbur efektin, sepse e njëjta është përmbushur nga ana e debitorit.

Gjykata vendosi si në pikën II të dispozitivit, duke lënë në fuqi pjesën tjetër të urdhrin P.nr.639/22 të datës 21.12.2022, për shumën në vlerë 13,137.02 €, për faktin se Fatura nr.FS09317 e datës 31.03.2020, Fatura nr.FS09329 e datës 04.04.2020, Fatura nr.FS09330 e datës 04.04.2020, Fatura nr.FS09347 e datës 07.04.2020, Fatura nr.FS09371 e datës 10.04.2020, Fatura nr.FS09433 e datës 27.04.2020, Fatura nr.FS096196 e datës 16.05.2020, Fatura nr.FS09465 e datës 02.05.2020, në bazë të së cilave është lejuar urdhri për përmbarim, i plotësojnë kushtet për të qenë dokumente të besueshme dhe i përmbajnë të gjitha elementet e kërkuara, në përputhje me nenin 29 dhe 37 të LPP-së.

Sipas nenit 29 paragrafit 1 të LPP-së, përcaktohet se “Përmbarimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm” dhe me paragrafin 3 të njëjtit nen, përcaktohet se “Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbarim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar”, ndërsa me nenin 37 të LPP-së, përcaktohet se “Kur propozimi për përmbarim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t’i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit ” dhe sipas nenin 29 paragrafit 1 nën paragrafit 1.3 të LPP-së, fatura është përcaktuar si dokument i besueshëm, sipas të cilit mund të caktohet përmbarimi për realizimin e kërkesës në të holla.

Në rastin konkret gjykata vlerëson se urdhri i lejuar nga ana e përmbaruesit privat bazohet në dokumentin e besueshëm – përkatësisht Faturën nr.FS09317 e datës 31.03.2020, Faturën nr.FS09329 e datës 04.04.2020, Faturën nr.FS09330 e datës 04.04.2020, Faturën nr.FS09347 e datës 07.04.2020, Faturën nr.FS09371 e datës 10.04.2020, Faturën nr.FS09433 e datës 27.04.2020, Faturën nr.FS096196 e datës 16.05.2020, Faturën nr.FS09465 e datës 02.05.2020, të cilat i përmbajnë të gjitha tiparet e dokumentit të besueshëm sipas nenit 29

par.3 të LPP-së, meqenëse në këto fatura, janë treguar palët, përkatësisht kreditori dhe debitori, janë përshkruar mallrat të cilat kanë qenë objekt i faturave, është përcaktuar shuma e cila është detyrim për përmbushje nga ana e debitorit dhe të njëjtat janë pranuar nga debitori në mënyrë të rregullt.

Rrjedhimisht, Gjykata vlerëson se në rastin konkret faturat, i plotësojnë kushtet e përcaktuara në nenin 37 të LPP-së, për zbatimin e përmbarimit në bazë të dokumentit të besueshëm, pasi që të njëjtat janë dorëzuar në origjinal si dhe mbajnë nënshkrimin e pranimit të debitorit.

Gjykata vendosi që të mbetet në fuqi urdhri i përmbaruesit privat edhe në pjesën lidhur me kamatën prej 8%, dhe atë duke u bazuar në nenin 382 të LMD-së me të cilin përcaktohet se: *“Debitori që vonon në përmbushjen e detyrimit në të holla debiton, përpos borxhit kryesor, edhe kamatën”*, për faktin se debitori ka rënë në vonesë për përmbushjen e detyrimit në shumën prej 13,137.02 €, me çka rezulton se kreditorit i takon e drejta për kamatëvonesë lidhur me këtë shumë që nga momenti kur faturat janë bërë të arritshme për pagesë e deri në pagesën definitive.

Nisur nga fakti se në rastin konkret gjykata ka aprovuar pjesërisht prapësimin e debitorit duke u bazuar në nenin 12 paragrafin 2 të Ligjit Nr.05/L-118 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.04/L-139 për Procedurën Përmbarimore, me të cilin përcaktohet se: *“Në rast se e aprovon prapësimin, gjykata varësisht nga rrethanat e rastit e përfundon përmbarimin në tërësi ose pjesërisht dhe i anulon veprimet e kryera”*, gjykata vendosi si në pikën III të dispozitivit, dhe e përfundoi pjesërisht procedurën e përmbarimit.

Nga sa u tha më lart, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi, duke u bazuar në nenin 71 dhe nenin 73 të LPP-së, nenin 12 par. 2 të Ligjit Nr.05/L-118 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.04/L-139 për Procedurën Përmbarimore, si dhe nenin 13 par.1 nën par. 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale.

## GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.99/23, datë 09.07.2023

Gjyqtarja  
Verona Dibra

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimi të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.